

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Zhvillimit Rajonal*  
*Ministarstvo za Regionalni Razvoj*  
*Ministry of Regional Development*

Datë: 23.12.2024


Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, z. Besim Kamberaj, bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L - 113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, bazuar në Ligjin nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Udhëzuesi për Identifikimin e Zonave për Investime Strategjike dhe Studimin e Fizibilitetit për Zhvillim Socio – Ekonomik Rajonal.
2. Obligohet Departamenti për Performancë dhe Analiza Rajonale, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenteve/Divizioneve;
- Arkivit të MZHR-së.

**Besim Kamberaj**  
  
**Sekretar i Përgjithshëm në MZHR**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

---

Ministria e Zhvillimit Rajonal/Ministry of Regional Development/Ministarstvo za Regionalni Razvoj  
Departamenti për Performancë dhe Analiza Rajonale

**UDHËZUES PËR ‘IDENTIFIKIMIN E ZONAVE PËR INVESTIME  
STRATEGJIKE DHE STUDIMI I FIZIBILITETIT PËR ZHVILLIM  
SOCIO – EKONOMIK RAJONAL’**


**Dhjetor, 2024**

**Prishtinë<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Udhëzuesi për Identifikimin e Zonave për Investime Strategjike dhe Studimin e Fizibilitetit për Zhvillim Socio – Ekonomik Rajonal, miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm I MZHR-së, me Vendimin Nr. 1177, dt. 23.12.2024.

Harta 1. Rajonet statistikore të propozuara në Kosovë



ASK, Shtator 2021, (Vula)

Rajonet zhvillimore sipas fushëveprimtarisë së Ministrisë së Zhvillimit Rajonal:

01 - Rajoni Qendër

02 - Rajoni Veri

03 - Rajoni Perëndim

04 - Rajoni Jug

05 - Rajoni Juglindje

06 - Rajoni Lindje

07 - Rajoni Jugperëndim

Udhëzuesi për Identifikimin e Zonave për Investime Strategjike dhe Studimi i Fizibilitetit për Zhvillim Socio – Ekonomik Rajonal mbështetet nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), i bazuar në Ligjin për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Planin Kombëtar për Zhvillim 2024 – 2026, në Planin e Brendshëm të Punës së MZHR-së për vitin 2024 nga Departamenti për Performancë dhe Analiza Rajonale (DPAR).

Ky udhëzues është hartuar nga grupi punues me përfaqësues nga MZHR-ë njëherit bartës të procesit, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe përfaqësues nga pesë (5) Agjencitë për Zhvillim Rajonal (AZHR).

Konsultuar me Sekretarin e Përgjithshëm dhe Kabinetin e Ministrit të MZHR-së.

## **Përmbajtja:**

|  |           |
|--|-----------|
| <b>1. Hyrje.....</b>   | <b>5</b>  |
| <b>2. Përkufizimet.....</b>  | <b>6</b>  |
| <b>3. Objektivat e Studimit.....</b>   | <b>7</b>  |
| <b>4. Metodologjia e Studimit.....</b>   | <b>7</b>  |
| <b>5. Roli dhe Rëndësia e Identifikimit të Zonave për Investime Strategjike dhe Studimi i Fizibilitetit për Zhvillim Socio – Ekonomik Rajonal .....</b>            | <b>8</b>  |
| <b>6. Kriteret për Identifikimin e Zonave .....</b>  | <b>9</b>  |
| <b>7. Studimi i Fizibilitetit të Projekteve për Investime në Zonat e Identifikuara .....</b>   | <b>10</b> |
| <b>8. Natyra e Projekteve dhe Korniza Ligjore për Investime Strategjike.....</b>   | <b>12</b> |
| <b>9. Elementet Kryesore për Vlerësimin e Projekteve Strategjike.....</b>  | <b>14</b> |
| <b>10. Burimet e financimit.....</b>   | <b>16</b> |
| <b>11. Organizimi dhe Planifikimi i Strukturave Organizative për Zbatimin e Udhëzuesit.....</b>  | <b>16</b> |
| <b>12. Interesat dhe Përfitimet nga Koordinimi i Aktiviteteve të Grupit Koordinues në Nivel Qendror dhe Grupeve Punuese në Nivel Rajonal.....</b>                  | <b>18</b> |
| <b>13. Përmbledhje e Udhëzuesit për Identifikimin e Zonave për Investimeve Strategjike dhe Studimin e Fizibilitetit për Zhvillim Socio – Ekonomik Rajonal.....</b> | <b>19</b> |

## 1. Hyrje

Investimet strategjike luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin socio – ekonomik të rajoneve, duke krijuar mundësi për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe përmirësim të standardit të jetesës së qytetarëve. Identifikimi i zonave të përshtatshme për këto investime dhe vlerësimi i fizibilitetit, është një proces i rëndësishëm që ndihmon në kanalizimin e resurseve në mënyrë më efektive dhe efektive.

**Qëllimi i udhëzuesit:** është të ofrojë një kornizë të qartë dhe të strukturuar për identifikimin e zonave me potencial të lartë për investime strategjike në rajonet zhvillimore dhe kryerjen e studimeve të fizibilitetit për projektet investive në këto zona. Procesi i identifikimit përfshin analizën e një sërë faktorësh ekonomikë, social dhe mjedisorë që përcaktojnë potencialin për zhvillim. Përderisa, studimi i fizibilitetit do të ndihmojë në vlerësimin e mundësive dhe sfidave të këtyre investimeve, duke siguruar që projektet të jenë të realizueshme dhe të kenë ndikim pozitiv në zhvillimin socio – ekonomik rajonal.

**Rëndësia e udhëzuesit:** udhëzuesi për identifikimin e zonave për investime strategjike dhe studimi i fizibilitetit për zhvillim socio – ekonomik rajonal, është një dokument kyç për adresimin e nevojave të zhvillimit rajonal të balancuar dhe të qëndrueshëm. Rëndësia e tij qëndron në disa aspekte kryesore:

- Identifikimi i potencialeve strategjike, ku udhëzuesi ndihmon në identifikimin e zonave me potencial të lartë për investime, duke siguruar që gjitha burimet që një rajon ka në dispozicion, qofshin ato financiare, natyrore, njerëzore apo edhe infrastrukturore, të përqëndrohen në projekte që kanë ndikim më të madh në zhvillimin socio – ekonomik.
- Mbështetja e vendimmarrjes së bazuar në të dhëna, ku udhëzuesi ofron një kornizë analitike për vlerësimin e fizibilitetit të projekteve dhe ndihmon në hartimin e strategjive për investime të qëndrueshme.
- Balancimi i zhvillimit rajonal, udhëzuesi kontribuon në reduktimin e pabarazive mes rajoneve, duke promovuar zhvillim ekonomik dhe duke nxitur përfshirjen e tyre në ekonominë shtetërore.
- Mbështetja për zhvillim të qëndrueshëm, për të cilat udhëzuesi siguron që investimet të planifikohen dhe të realizohen në harmoni me ruajtjen e burimeve natyrore, zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve në rajonet zhvillimore.
- Përmirësimi i politikave dhe programeve qeveritare, ku udhëzuesi mund të përdoret si një mjet për hartimin dhe zbatimin e politikave rajonale më të fokusuara në prioritetet specifike të identifikuara për rajonet zhvillimore, duke u bazuar në potencialet unike dhe nevojat konkrete të tyre, si dhe politikat rajonale të integruara me një qasje të harmonizuar dhe të përbashkët midis qeverisë qendrore dhe komunave për sektorë të ndryshëm si në infrastrukturë, mjedis, ekonomi etj.

## 2. Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë udhëzues kanë këtë kuptim:

**Rajon zhvillimor** – nënkupton territorin funksional që përfshinë dy apo më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale, në përputhje me kriteret NUTS-3, për zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal të balancuar, i cili dallohet nga një tërësi karakteristikash gjeografike, socio – ekonomike, kulturore dhe mjedisore. Rajoni zhvillimor përfshinë zhvillimin socio – ekonomik rajonal të balancuar, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin përkatës dhe në asnjë rrethanë nuk nënkupton organizim administrativ apo territorial.

**Zhvillim rajonal i balancuar** – nënkupton procesin e uljes së dallimeve në aspekt të zhvillimit socio – ekonomik si dhe përafrimi i nivelit të zhvillimit ekonomik, social, kulturore e mjedisor, ndërmjet rajonevetë ndryshme zhvillimore përmes shfrytëzimit të potencialeve të tyre sa i përket resurseve financiare, natyrore dhe kapitalit njerëzor.

**Pabarazi rajonale** – nënkupton gjendjen kur evidentohen dallime substanciale në mes rajoneve zhvillimore sipas indikatorëve socio – ekonomik.

**Politikat e zhvillimit rajonal të balancuar** – nënkupton kornizën e dokumenteve strategjike dhe planifikuese të zhvillimit rajonal të balancuar me qëllim të intervenimeve në fusha të caktuara të cilat do të zbatohen për arritjen e synimit të zhvillimit rajonal të balancuar. Varësisht nga ndryshimet dhe avancimi i dokumenteve strategjike, objektivat e zhvillimit rajonal të balancuar, do t'i referohen dhe adaptohen ndryshimeve të fundit.

**Zonë** – nënkupton një territor apo vend të kufizuar, ku zhvillohet një veprimtari e caktuar: gjeografikisht (pjesë e një brezi të tokës që ka klimë, lagështirë, bimësi dhe pamje të jashtme pak a shumë të njëjtë). Administrativisht (vend, hapsirë që dallohet për veçoritë natyrore dhe klimatike) si dhe ekonomikisht (pjesë e madhe e një vendi që dallohet sipas disa tipareve të veçanta sipërfaqe e caktuar e mbjellur me bimë, që ka disa fabrika etj.) e cila shquhet për potencialin e saj për investime strategjike dhe zhvillim. Zonat mund të identifikohen në bazë të karakteristikave të tyre natyrore, ekonomike, demografike apo sipas infrastrukturës ekzistuese dhe janë të destinuara për zhvillim të mëtejshëm socio – ekonomik me qëllim të rritjes së prosperitetit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës.

**Identifikimi i zonave** – nënkupton procesin e analizës dhe vlerësimit për të përcaktuar territorin me potencial të lartë për investime strategjike, bazuar në kriteret e caktuara si kapacitetet ekonomike, pozita gjeografike, infrastruktura ekzistuese dhe ndikimet e mundshme sociale dhe mjedisore. Ky proces synon të nxjerrë në pah ato zona që kanë mundësi të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin rajonal dhe ekonomik.

**Investim strategjik** – një investim në sektorët prioritar dhe/apo objektivat e përcaktuara në Ligjin Nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme;

**Investim i qëndrueshëm** – një investim afatgjatë në Republikën e Kosovës në një aktivitet ekonomik që kontribuon në përmbushjen një apo më shumë objektivave dhe sektorëve prioritar të përcaktuar me Ligjin Nr.08/L-209 për Investime të Qëndrueshme;

**Studimi i fizibilitetit** – është një analizë e hollësishme e një projekti të propozuar për të vlerësuar nëse ai është ekonomikisht i realizueshëm, teknikisht i mundshëm dhe në aspektin social i pranueshëm. Ky studim shqyrton kostot, përfitimet, rreziqet dhe burimet e nevojshme për zbatimin e projektit, si dhe vlerëson ndikimet mjedisore dhe shoqërore. Synimi i tij është të japë një pasqyrë të qartë nëse projekti ka kuptim të vazhdojë dhe cilat kushte duhet të plotësohen për realizim të suksesshëm për zhvillim socio – ekonomik rajonal.

### 3. Objektivat e Studimit

- **Identifikimi i zonave me potencial për investime strategjike**, është i rëndësishëm për të analizuar faktorët ekonomikë, socialë dhe mjedisorë të rajoneve zhvillimore;
- **Studimi i fizibilitetit të projekteve për investime në zonat e identifikuara**, ka rëndësi të theksuar për arsye se do të kryejë analizat e nevojshme për të vlerësuar realizueshmërinë e projekteve dhe investimeve në zonat e identifikuara dhe ndikimin e tyre në zhvillimin socio – ekonomik të rajonit zhvillimor;

### 4. Metodologjia e Studimit

Metodologjia e studimit, i mundëson përdoruesit të identifikojë, vlerësojë dhe planifikojë investimet strategjike me ndikim thelbësor në zhvillimin socio – ekonomik në rajonet zhvillimore, duke theksuar një qasje të integruar dhe duke përfshirë sektorët e ndryshëm të zhvillimit rajonal. Udhëzuesi ofron shpjegime të hollësishme për çdo hap të procesit duke përfshirë hulumtimin, analizën e tregut, vlerësimin e mundësive dhe hartimin e raportit përfundimtar të identifikimit të zonave dhe mundësive për investime strategjike, duke u bazuar në studimin e fizibilitetit për projektin e caktuar.

Për arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë udhëzues, është i rëndësishëm zbatimi i planit duke përfshirë:

- **Fazën e Identifikimit**, e cila përfshinë përdorimin e analizave të të dhënave për të identifikuar zonat me potencial për investime strategjike, si analiza demografike, ekonomike, infrastrukurore dhe konsultime me akterë të ndryshëm lokalë dhe ekspertë për të mbledhur informacione të plota.
- **Fazën e Studimit të Fizibilitetit**, përfshinë kryerjen e analizave financiare dhe teknike për të vlerësuar mundësitë e investimeve në zonat e identifikuara, analizën e ndikimeve mjedisore dhe sociale dhe përdorimi i modeleve dhe mjeteve analitike për të vlerësuar fizibilitetin dhe përfitimet e mundshme.

**Qasja dhe metodat e studimit**, do të përdoren për të identifikuar zonat me potencial për investime strategjike, duke përfshirë mjete dhe teknika specifike të cilat do të përdoren për të mbledhur, analizuar dhe interpretuar të dhënat për të realizuar këtë studim, andaj, për të arritur rezultatin e dëshiruar, është me rëndësi përdorimi i këtyre metodave:

- **Metoda hulumtuese**, përfshin përdorimin e intervistave dhe vëzhgimin e ngjarjeve për të mbledhur dhe analizuar të dhënat, të cilat janë të nevojshme për të kuptuar shqetësimet specifike, nevojat dhe mundësitë e komunitetit për zhvillimin e rajonit.

- **Metoda përshkruese**, synon të përshkruajë situatën aktuale duke analizuar dhe paraqitur të dhëna në një mënyrë objektive. Përdorimi i kësaj metode mund të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të detajuar të aspektit të tanishëm të rajonit zhvillimor, duke përfshirë strukturën ekonomike, infrastrukturën dhe karakteristikat kulturore.
- **Metoda analitike**, përfshin shqyrtimin e faktorëve të ndryshëm të një situatë për të kuptuar lidhjet dhe ndikimet midis tyre. Në studimin e fizibilitetit, përdorimi i kësaj metode do të ndihmojë në kuptimin e ndërveprimit të këtyre faktorëve dhe të sjellë një vlerësim më të thellë të impaktit të projekteve të mundshme.
- **Metoda krahasuese**, mundëson të nxirren mësim të rëndësishme nga përvoja e rajoneve të tjera, zhvillimore, duke ndihmuar në hartimin e strategjive dhe planeve të përshtatshme, e cila ofron një perspektivë më të gjërë dhe ndihmon në të kuptuarit e veçantive dhe potencialeve të rajonit zhvillimor të studjuar.

Metodat e përfshira në këtë studim, mundësojnë sigurimin e informacioneve të pasura, të plota dhe të diversifikuara. Kombinimi i tyre mund të ofrojë një përmbledhje të kompletuar dhe një kuptim të thellë të sfidave dhe mundësive që mund të paraqiten në zhvillimin rajonal.

## **5. Roli dhe Rëndësia e Identifikimit të Zonave për Investime Strategjike dhe Studimi i Fizibilitetit për Zhvillim Socio – Ekonomik Rajonal**

Identifikimi i zonave për investime strategjike dhe studimi i fizibilitetit ka rol të rëndësishëm në procesin e zhvillimit rajonal, duke krijuar një bazë të fortë për vendimmarrje dhe alokim të saktë të burimeve. Roli i këtyre dy komponentëve është të sigurojë që investimet të orientohen drejt zonave me potencial të lartë për zhvillim ekonomik, duke minimizuar rreziqet dhe duke maksimizuar përfitimet.

Identifikimi i zonave ndihmon në përcaktimin e hapsirave ku investimet mund të kenë impakt të madh në rritje ekonomike, punësim dhe përmirësim të infrastrukturës lokale. Ndërkohë, studimi i fizibilitetit luan një rol të rëndësishëm në këtë proces, duke ofruar një analizë të hollësishme të mundësive, duke siguruar që vendimet të bazohen në të dhëna të sakta dhe analiza të mirëfillta të rreziqeve dhe përfitimeve.

Rëndësi e identifikimit të zonave për investime strategjike është një proces vendimtar dhe shumë i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm socio – ekonomik të rajoneve. Identifikimi i zonave ndihmon në përcaktimin e zonave me potencial të lartë për rritje ekonomike dhe përmirësim të mirëqenies së komuniteteve lokale. Përmes një analize të hollësishme të burimeve natyrore, infrastrukturës ekzistuese dhe tregjeve të mundshme, bëhet i mundur selektimi i zonave ku investimet mund të gjenerojnë përfitime maksimale.

Studimi i fizibilitetit luan rol të rëndësishëm në këtë proces, duke ofruar një vlerësim të plotë të kostove, përfitimeve dhe rreziqeve të investimeve të planifikuara. Studimi ndihmon në minimizimin e pasigurive dhe garanton që investimet strategjike të jenë të qëndrueshme dhe me ndikim afatgjatë. Ky studim siguron që zonat e identifikuar të kenë mundësi reale për zhvillim, duke i dhënë prioritet zhvillimit të infrastrukturës, promovimit të inovacionit dhe krijimit të vendeve të punës.

Përmes këtij procesi, rajonet zhvillimore fitojnë kapacitet më të lartë për të tërhequr investitorë të huaj dhe vendor, duke krijuar një ekonomi më konkurruese dhe duke reduktuar pabarazitë midis rajoneve. Zhvillimi socio – ekonomik i bazuar në identifikimin dhe studimin e zonave për investime strategjike është një mënyrë efektive për të rritur prosperitetin e përgjithshëm dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve.

## 6. Kriteret për Identifikimin e Zonave

Identifikimi i zonave të përshtatshme për investime strategjike kërkon analizë të thelluar të një sërë faktorësh dhe kriteresh që përcaktojnë potencialin e një zone për zhvillim. Kriteret kryesore për trajtimin e identifikimit të zonave për investime strategjike, janë si në vijim:

- **Faktorët ekonomik**, në kuadër të të cilëve hyjnë **potenciali për rritje ekonomike** i cili analizon treguesit ekonomikë si GDP-ja rajonale, normat e rritjes ekonomike, sektorët kryesorë të ekonomisë si dhe zonat me rritje të qëndrueshme dhe sektorë të ndryshëm që kanë potencial më të lartë për të tërhequr investime. **Infrastruktura**, për të cilën parashihet të vlerësohet cilësia dhe disponueshmëria e infrastrukturës, duke përfshirë rrugët, hekurudhat, infrastruktura digjitale dhe sektorë tjerë me interes, për arsye se zonat me infrastrukturë të mirë janë më tërheqëse për investitorët. **Kostot e operimit**, në kuadër të të cilave duhet analizuar kostoja e energjisë, ujit, punimeve dhe tokës, për arsye se zonat me kosto më të ulët mund të jenë më atraktive për investitorët.
- **Faktorët socialë**, ku do të vlerësohen **karakteristikat e popullsisë dhe demografisë**, përfshirë numrin e popullsisë, strukturën e moshës dhe nivelin e edukimit. Zonat me popullsi të re dhe të arsimuar mund të kenë një bazë më të mirë për fuqinë punëtore. **Standardi i jetës**, ku vlerësohen treguesit për standardin e jetës, përfshirë të ardhurat mesatare, qasjen në shërbime shëndetësore dhe arsimore dhe cilësia e jetës. Zonat me standard të lartë jetese mund të jenë më atraktive për punonjësit dhe investitorët. **Stabiliteti social**, do të analizohet stabiliteti social dhe niveli i krimit. Zonat me nivel të ulët të krimit dhe një mjedis social janë më tërheqëse për investime.
- **Faktorët mjedisorë**, do të vlerësohen **ndikimet mjedisore** të investimeve të mundshme, përfshirë ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës. Zonat që mund të përballojnë ndikimet mjedisore të investimeve janë më të përshtatshme. **Qëndrueshmëria e burimeve natyrore**, vlerësohet disponueshmëria dhe qëndrueshmëria e burimeve natyrore, duke përfshirë, ujë, tokë, dhe energji. Zonat me burime natyrore të bollshme dhe të qëndrueshme janë më atraktive për investime. **Korniza ligjore**, më me përparësi konsiderohen zonat me mbrojtje ligjore të mjedisit, të cilat janë të qëndrueshme dhe tërheqëse për investitorët të cilët kërkojnë të operojnë në mënyrë më të përgjegjshme.
- **Legjislacioni dhe politikat përkatëse**, ka për qëllim sigurimin që projektet të zbatohen në përputhje me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme, si: **Legjislacioni shtetror**, i cili përfshin përshkrimin e ligjeve që lidhen me zhvillimin rajonal, mbrojtjen e mjedisit dhe investimet strategjike. **Rregulloret lokale**, përfshin vendosjen e politikave lokale dhe rregulloreve specifike për zonat e identifikuara. **Përputhshmëria**, përfshin sigurimin që të gjitha aspektet e projektit të jenë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi, duke marrë për bazë edhe Planin Hapësinor të Kosovës.
- **Faktorë të tjerë**, mund të jenë **politikat dhe mbështetja institucionale** ku do të analizohen politikat qeveritare dhe mbështetja institucionale për investime strategjike. Zonat me mbështetje të fortë nga qeveria dhe institucionet lokale janë më tërheqëse për investitorët. **Pjesëmarrja e komunitetit**, vlerësohet niveli i përfshirjes së komunitetit lokal për investimet e mundshme. Zonat ku komuniteti lokal është i përfshirë dhe mbështet investimet kanë më shumë gjasa të jenë të

suksesshme. **Zona me potencial për inovacion dhe zhvillim të teknologjisë**, është me përparësi për investime strategjike për shkak të potencialit në inovacion dhe zhvillimit të teknologjisë në atë zonë, janë më tërheqëse për investime për shkak të mundësisë për përdorim të teknologjisë së avancuar.

Përdorimi i këtyre kriterëve për autoritetet rajonale dhe investitorët lehtëson identifikimin e zonave me potencial për investime strategjike e që është me ndikim në zhvillimin socio – ekonomik rajonal, në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive. Kjo qasje ndihmon në kanalizimin e burimeve në mënyrë më të mirë dhe rrit përfitimet për komunitetin lokal dhe ekonominë e përgjithshme të rajonit.

## **7. Studimi i Fizibilitetit të Projekteve për Investime në Zonat e Identifikuara**

Studimi i fizibilitetit është hap kyç dhe shumë i rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes për investime strategjike të projekteve në zonat e identifikuara, duke përfshirë analiza të detajuara të faktorëve financiarë, teknikë, ekonomikë, socialë dhe mjedisorë për të vlerësuar realizueshmërinë dhe ndikimin e mundshëm të investimeve në zhvillimin rajonal.

Para se të fillohet procesi për studimin e fizibilitetit të projekteve specifike për investime strategjike në zonat e identifikuara, duhet konsultuar Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve e themeluar në kuadër të Kryeministrit, për t'u siguruar se a i plotëson kushtet dhe kriteret projekti X i paraparë për investime strategjike për të vazhduar me studimin e fizibilitetit, bazuar në Ligjin për Investime të Qëndrueshme. Më pas për studimin e fizibilitetit do të vazhdojnë procedurat dhe bashkëpunimi me Agjencinë për Inovacion dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës (AIPNK), i themeluar në kuadër të MINT.

Komponentet kryesore të studimit të fizibilitetit:

### **Analiza financiare**

- Parashehë koston fillestare e investimit, e cila përfshin vlerësimin e koston fillestare të ndërtimit dhe zhvillimit të projektit, koston e tokës, ndërtimit, paisjeve dhe materialeve;
- Shpenzimet operative, përfshin analizën e koston operative të vazhdueshme si kosto e energjisë, ujit, mirëmbajtjes dhe fuqisë punëore;
- Analiza e të ardhurave, përfshin vlerësimin e burimit të të ardhurave të pritura nga investimi, shitjet, qiratë dhe burimet e tjera të të ardhurave;
- Analiza e rrishtit financiar, përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rrishtit të mundshëm financiar dhe planifikimin e masave për menaxhimin e tyre.

### **Analiza teknike**

- Vlerësimin e infrastrukturës, përfshin vlerësimin e kapaciteteve dhe cilësinë e infrastrukturës ekzistuese si bazë për të mbështetur projektin, rrugët, rrjetet e energjisë, furnizimin me ujë dhe kanalizimet;
- Kërkesat teknologjike, përfshin identifikimin e teknologjisë së nevojshme për realizimin dhe funksionimin e projektit, për të cilat duhet vlerësuar disponueshmërinë dhe koston e këtyre teknologjive;
- Analiza e prodhimit dhe kapacitetit, përfshin vlerësimin e kapacitetit të prodhimit ose shërbimeve të ofruara nga projekti, duke marrë parasysh faktorin e efikasitetit dhe cilësisë;

- Zhvillimi dhe implementimi i projektit, përfshin përcaktimin e hapave të nevojshëm për zhvillimin dhe implementimin e projektit, duke përfshirë fazat e planifikimit, ndërtimit dhe operimit.

#### **Analiza ekonomike**

- Ndikimi në ekonominë lokale, përfshin vlerësimin e ndikimit të mundshëm të investimit në ekonominë lokale, përfshirë krijimin e vendeve të punës, rritjen GDP-së lokale dhe përmirësimin e të ardhurave për banorët;
- Rritja dhe përfshirja e sektorëve të ndryshëm ekonomik, përfshin vlerësimin se si investimi mund të kontribuojë në rritjen dhe përfshirjen e sektorëve të ndryshëm në zhvillimin e ekonomisë lokale, duke shtuar sektorë të rinj dhe duke rritur qëndrueshmërinë ekonomike;
- Përfitimet dhe ndikimet negative, përfshin analizën e përfitimeve dhe ndikimet negative që një projekt shkakton për palët e treta të cilat nuk janë të përfshira drejtëpërdrejtë në atë projekt, të cilat mund të jenë ndotja e ajrit, ujit dhe zhurma.

#### **Analiza sociale**

- Ndikimi i komunitetit lokal, përfshin vlerësimin e ndikimit të investimeve në komunitetin lokal, si përmirësimi i cilësisë së jetës, qasjen në shërbime dhe përfshirjen e komunitetit në projekt;
- Edukimi dhe trajnimi, përfshin analizën e mundësive për edukim dhe trajnim të fuqisë punëtore lokale si rezultat i investimit dhe ndikimin e këtyre përmirësimeve në zhvillimin socio-ekonomik rajonal;
- Shërbimet sociale, përfshin vlerësimin e ndikimit në ofrimin e shërbimeve sociale si, shëndetësi, arsim dhe shërbime publike;
- Ndikimet kulturore, përfshin analizën e ndikimit të mundshëm kulturor dhe përfitimet kulturore lokale si rezultat i investimit.

#### **Analiza mjedisore**

- Ndikimi mjedisor, përfshin vlerësimin e ndikimit të projektit në mjedis, duke përfshirë ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, si dhe ndikimet në biodiversitetin lokal;
- Menaxhimi i ndikimeve, përfshin identifikimin e masave për menaxhimin dhe zvoglimin e ndikimeve negative mjedisore, planet e rimëkëmbjes dhe riparimet;
- Përdorimi i burimeve natyrore, përfshin analizën e përdorimit dhe qëndrueshmërinë e burimeve natyrore të nevojshme për projektin, duke përfshirë ujin, energjinë dhe materialet natyrore;
- Paisja me rregulloret mjedisore, përfshin vlerësimin e pajtueshmërisë së projektit me rregulloret dhe standardet mjedisore lokale dhe ndërkombëtare.

#### **Planifikimi dhe implementimi i projektit**

- Plani i zbatimit, përfshin përcaktimin e hapave dhe afateve kohore për zbatimin e projektit, duke përfshirë fazat e ndërtimit, operimit dhe monitorimit;
- Menaxhimi i projektit, përfshin përcaktimin e strukturave organizative, rolet dhe përgjegjësitë për menaxhimin efektiv të projektit;
- Monitorimi dhe vlerësimi, përfshin vendosjen e mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të projektit dhe ndikimet e tij gjatë gjithë ciklit të realizimit të projektit.

#### **Rekomandimet për investime**

- Rekomandimet për investime strategjike, përfshin formulimin e rekomandimeve për investime strategjike bazuar në analizat e kryera, duke identifikuar zonat dhe projektet me potencial më të lartë për sukses;
- Politikat dhe strategjitë, përfshin sugjerimet për politikat dhe strategjitë që mund të përmirësojnë mjedisin për investime dhe ofrimin e mbështetjes për zhvillim të qëndrueshëm socio – ekonomik në rajonet e targetuara.

Këto komponente të studimit të fizibilitetit ndihmojnë në vlerësimin e plotë të potencialit dhe sfidave të investimeve në zonat e identifikuara, duke siguruar që vendimet të bazohen në të dhëna dhe analiza të sakta.

## 8. Natyra e Projekteve dhe Korniza Ligjore për Investime Strategjike

Investimet strategjike janë një element kyç për zhvillimin socio – ekonomik të rajoneve zhvillimore, duke kontribuar në rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e infrastrukturë. Për të siguruar që këto investime të jenë të qëndrueshme dhe me ndikim të lartë, është e domosdoshme që ato të bazohen në një kornizë të qartë ligjore dhe të përcaktohen nga natyra e projekteve që përmbushin kritere të caktuara strategjike. Ky seksion eksploron karakteristikat kryesore të projekteve që konsiderohen si strategjike dhe bazën ligjore që rregullon procesin e identifikimit dhe përzgjedhjes së tyre, duke siguruar një qasje transparente dhe efektive në përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit rajonal.

**Ligji Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar** – sipas të cilit përgjegjëse për zhvillim rajonal është Ministria e Zhvillimit Rajonal. Në kuadër të kësaj hartimi i politikave për zhvillim rajonal specifikisht paraqitet në **Kapitullin II Politikat për Zhvillim Rajonal të Balancuar**, neni 7 Dokumentet dhe politikat e zhvillimit rajonal të balancuar, paragrafi 1 shprehimisht parasheh që *“Zhvillimi rajonal i balancuar mbështetet në dokumentet planifikuese ku përcaktohen prioritetet dhe programet e zhvillimit rajonal të cilat i përgatit ministria dhe i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratim”*. Si dhe në Kapitullin IV Struktura Institucionale për Zhvillim Rajonal të Balancuar, neni 14 Institucionet dhe trupat përgjegjës për zhvillim rajonal të balancuar, paragrafi 3. *“Politikat për zhvillim rajonal të balancuar i propozon ministria, ndërsa i miraton qeveria”*.

**Ligjin Nr. 08/L – 209 për Investime të Qëndrueshme** – rregullon Statusin e investimit strategjik ose projektin investues strategjik, i cili është i rregulluar dhe fitohet sipas kriterëve dhe procedurave të parapara në këtë ligj nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tragtisë. **Kapitulli IV Organet Kompetente për Investime**, neni 17 Politikat për investime, neni 18 Themelimi i agjencive, nënparagrafi 1.1. parashehë themelimin e Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve (AIE); nënparagrafi 1.2. Agjencia për Inovacion dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës (AIPNK)

Neni 19, Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve, paragrafi 1. *“AIE themelohet në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, si egjenci ekzekutive sipas legjislacionit përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe organeve të pavarura”*, ku në kuadër të kompetencave në paragrafin 3. *“Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për investime strategjike nënkupton”*, pranimin e propozimeve, përgatitjen e dosjes për shqyrtimin e projektit investues dhe qështje tjera deri në dorëzimin e dosjes së projektit të kompletuar te Këshilli.

Neni 20, Agjencia për Inovacion dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës (AIPNK), e themeluar me këtë ligj në kuadër të MINT, përshkruan qartë kompetencat e agjencisë ku ndër të tjera në nënparagrafin 2.4.2. *“Përgatitja dhe vlerësimi i studimit të fizibilitetit dhe masterplaneve për zhvillimin e zonave”*.

Ndërsa, neni 21 Këshilli, paragrafi 1. *“Këshilli i investimeve në Republikën e Kosovës bënë vlerësimin, përzgjedhjen, zbatimin, mbikëqyrjen dhe vendos për projektet për investime strategjike në përputhje me dispozitat ligjore të këtij ligji”*. Në paragrafin 2 të nenit 21, parashihet përbërja e këshillit e cila kryesohet nga kryeministri, në paragrafin 4. Këshilli ushtron këto përgjegjësi, nënparagrafi 4.2. nxjerr vendime për investimet strategjike sipas nenit 36 të këtij ligji.

Përveç tjerash, neni 23. Detyrimi i bashkëpunimit, në paragrafin 1 shprehimisht parashehë që *“Çdo autoritet publik ka detyrë të bashkëpunojë me Këshillin, AIE dhe Panelin Ankimor dhe të ndihmojë në zbatimin e këtij ligji”*. Ndërsa në paragrafin 2. të këtij neni, *“Dështimi i zyrtarit publik për të bashkëpunuar sipas paragrafit 1 të këtij neni përbën shkelje të rëndë të detyrës, sipas ligjit përkatës për Zyrtarët Publik”*.

**Kapitulli V Investimet Strategjike**, neni 24 rregullon Kushtet e Përgjithshme, paragrafi 3, ku shprehimisht thot, *“Investimi strategjik duhet të arrijë vlerën së paku dhjetë (10) milionë euro”*.

Neni 28 i po këtij ligji, rregullon shfrytëzimin e pronave të paluajtshme publike të cilat jepen në shfrytëzim për investime strategjike dhe miratohen varësisht nga cili nivel (Republikës së Kosovës apo komunës përkatëse) është pronësia.

Andaj, bazuar në rregullativën ligjore, grupi punues në nivel rajonal luan një rol kyç në procesin e identifikimit të zonave dhe përcaktimit të projekteve me potencial për investime strategjike. Pasi kryen analiza dhe përzgjedhje të projekteve për investime strategjike në rajonin zhvillimor, përgatit dosje të detajuar që përmban të gjitha informacionet dhe dokumentacionin mbështetës për projektet e përzgjedhura. Kjo dosje i përcillet Grupi Koordinues në nivel qendror i cili përmes Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, e përcjell atë në Agjencionin e Investimeve dhe Eksporteve (AIE), për verifikim të kritereve dhe të dhënave të paraqitura dhe i njejtë i rekomandon Këshillit i cili merr vendimin përfundimtar për shpalljen e projektit si investim strategjik, duke siguruar koordinim dhe vendimmarrje në nivelin më të lartë shtetëror.

**Projektet e mundshme për investime strategjike** – përqëndrohen në identifikimin dhe zhvillimin e iniciativave që kanë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor në rajonet zhvillimore. Këto projekte duhet të i kontribuojnë rritjes afatgjatë të zhvillimit ekonomik, të kenë qëndrueshmëri për të krijuar mundësi të reja ekonomike e sociale, të ofrojnë mundësi të punësimit dhe zbatimit të teknologjive të reja, të cilat mund të jenë:

- **Projektet me ndikim të lartë ekonomik në rajonet zhvillimore**, të cilat duhet të kontribuojnë në rritjen e qëndrueshme ekonomike, duke krijuar vende pune, rritje të të ardhurave dhe përmirësimin e konkurrencës në treg. Këtu mund të përfshihen projektet në sektorët strategjik të energjisë me infrastrukturë dhe miniera, teknologjisë informative, transport dhe telekomunikacion, parqe industriale dhe teknologjike, turizëm.
- **Projektet strategjike që sigurojnë zhvillim rajonal të qëndrueshëm dhe me potencial të lartë për rritje**, duhet të kenë potencial për të sjellë inovacion, dhe avancime të rëndësishme, duke tërhequr më shumë investime dhe duke ndihmuar në rritjen e prodhimit dhe eksportit. Të promovojnë qëndrueshmëri mjedisore dhe të kontribuojnë në reduktimin e ndotjes dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme (si, energjia diellore, energjia e erës, energjia e ujit, burimet organike si drunjt, bimët, dhe mbetjet që mund të shëndrrohen në energji përmes djegies, energjia nga nxehtësia natyrore e tokës). Këto projekte synojnë të ndihmojnë në përballimin e sfidave të ndryshimeve klimatike dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës së komunitetit lokal.

- **Projektet me ndikim në përmirësimin e infrastrukturës së rajoneve zhvillimore**, duke përfshirë ndërtimin ose përmirësimin e rrugëve, ujësjellësit, administrimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave, të cilat mund të ndihmojnë zhvillimin e zonave të pazhvilluara dhe të përshpejtojnë qasjen e bizneseve dhe komunitetit në tregjet globale.
- **Projektet me ndikim në zhvillimin rajonal të balancuar**, duhet të fokusohen në nxitjen e zhvillimit rajonal të barabartë, duke përfshirë zonat më të pazhvilluara apo me potencial të pashfrytëzueshëm. Projektet që përmirësojnë qasjen në shërbime publike, në bujqësi dhe industri ushqimore dhe në infrastrukturë me prioritet për rajonet zhvillimore.
- **Projektet me përfitime sociale**, ku përveç ndikimit ekonomik, projektet duhet të kontribuojnë në përmirësimin e mirëqenies sociale, duke ndihmuar në zvogëlimin e pabarazisë, ofrimin e mundësive arsimore, shëndetësore dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët lokal.

## 9. Elementet Kryesore për Vlerësimin e Projekteve Strategjike

Kjo pjesë e udhëzuesit përqëndrohet në elementet themelore që janë thelbësore për zbatimin efektiv të projekteve strategjike dhe për sigurimin e suksesit afatgjatë të tyre. Për të arritur qëllimet e investimeve strategjike, është e nevojshme të kryhen analiza të thelluara të rrezikut dhe përfitimeve, të hartohen plane të qarta të zbatimit dhe të përfshihen palët e interesuara në proces. Po ashtu, mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit si dhe përputhja me rregulloret dhe politikat përkatëse, janë elemente kyçe për të siguruar që projektet të jenë të qëndrueshme dhe të arrijnë rezultatet e dëshiruara. Rekomandimet praktike dhe udhëzimet përkatëse do të ndihmojnë në përmirësimin e zbatimit dhe në përballjen me sfidat e mundshme, përfshirë këtu:

### Analiza e rrezikut

Qëllimi i analizës së rrezikut parasheh vlerësimin e rreziqeve të mundshme që mund të ndikojnë në suksesin e projekteve për investime strategjike në rajonet zhvillimore, të cilat mund të jenë:

- Rreziqet mjedisore, të cilat përfshin ndikimet negative në mjedis, si ndotja, shkatërrimi i pyjeve dhe humbja e biodiversitetit;
- Rreziqet financiare, të cilat lidhen me financimin e projektit, si luhatjet e normave të interesit, inflacioni dhe çështje tjera;
- Rreziqet e politikave, të cilat përfshijnë ndryshimet në legjislacion, politika fiskale dhe stabilitetin politik që mund të ndikojnë në zbatimin e projektit;
- Rreziqet sociale, të cilat përfshijnë ndikimet që mund të kenë projektet në komunitetin lokal, si mundësinë e zhvendosjes së popullatës apo tensione tjera sociale.

### Analiza e përfitimeve dhe kostove

Është me rëndësi të theksuar analiza e përfitimeve dhe kostove të përgjithshme të projekteve investive, me qëllim të përcaktimit nëse investimi është i vlefshëm. Këtu parashihet të vlerësohen:

- Përfitimet ekonomike, si krijimi i vendeve të punës, rritja e të ardhurave, zhvillimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i tregjeve lokale;

- Përfitimet sociale, si përmirësimi i standardit të jetesës, qasja në shërbime të përmirësuara publike dhe përmirësimi në arsim dhe shëndetësi;
- Kostot ekonomike, përfshirë koston fillestare të investimit, koston e mirëmbajtjes së projektit dhe koston e zhvillimit të projektit;
- Kostot sociale, përfshirë ndikimet në komunitetin lokal, si p.sh. ndryshimet në demografi dhe rritjen e koston të jetesës.

### **Plani i zbatimit**

Qëllimi i planit të zbatimit është të sigurojë që projektet e identifikuar të zbatohen në mënyrë të suksesshme dhe brenda afateve të përcaktuara, duke paraparë hapat e nevojshëm për zbatim, si në vijim:

- Hapat kryesorë, në të cilët parashihet përshkrimi i veprimeve të nevojshme për të zbatuar projektin, duke filluar nga planifikimi fillestar deri tek dorëzimi i projektit;
- Afatet kohore, të bëhet plani i përcaktimit të një kalendarit të qartë për zbatimin e projektit, duke përfshirë afatet për secilën fazë;
- Përgjegjësitë, përfshin identifikimin e individëve ose grupeve përgjegjëse për secilin aspekt të projektit;
- Burimet e nevojshme, përfshin identifikimin e burimeve materiale, njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatimin e planit;
- Menaxhimi i rrezikut, përfshin planifikimin e mënyrave për të menaxhuar dhe minimizuar rreziqet gjatë zbatimit të projekti

### **Përfshirja e palëve të interesuara**

Ka për qëllim të sigurojë mbështetje dhe bashkëpunim me komunitetin lokal dhe të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë:

- Identifikimin e palëve të interesuara, i cili parasheh klasifikimin e grupeve që kanë interes apo ndikim në projekt, si, autoritetet lokale, komunitetin dhe sektorin privat;
- Strategjia e përfshirjes, përfshin planin për komunikim me këto grupe dhe sigurimin se interesat dhe shqetësimet e tyre do të adresohen;
- Konsultimet publike, përfshirë takime, diskutime dhe sondazhe për të mbledhur mendime dhe sugjerime nga komuniteti dhe palët tjera të interesuara;

### **Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit**

Kanë për qëllim të sigurojnë që projekti të realizohet sipas planit dhe të arrihen rezultate e pritshme, duke përfshirë:

- Mekanizmat e monitorimit, si vendosjen e një sistemi të rregullt për të mbledhur dhe analizuar të dhënat gjatë gjitha fazave të projektit;
- Vlerësimi i ndërmjetëm, i cili realizohet gjatë zbatimit të projektit për të identifikuar dhe korrigjuar devijimet nga plani fillestar;
- Vlerësimet përfundimtare, përfshinë një analizë përfundimtare të projektit për të vlerësuar nëse janë arritur qëllimet dhe objektivat e projektit.

## **Rekomandimet**

Kanë për qëllim të ofrojnë udhëzime për hapat e ardhshëm që duhet të ndërmerren për të siguruar suksesin e vazhdueshëm të projektit, si në vijim:

- Hapat e ardhshëm, përfshin sugjerime për veprimet që duhet të ndërmerren për të adresuar çështjet e identifikuar gjatë zbatimit;
- Zhvillimi i mëtejshëm, përfshin identifikimin e mundësive për të zgjeruar ose përmirësuar projektet ekzistuese;
- Përmirësimi i proceseve, përfshin rekomandime për mënyrat se si të përmirësohen proceset e zbatimit dhe monitorimit;
- Përgatitja për sfidat e ardhshme, përfshin identifikimin e sfidave të mundshme dhe mënyrën për t'u përgatitur për ato.

## **10. Burimet e financimit**

Disa nga mundësitë e burimeve financiare që mund të shfrytëzohen apo përdoren për realizimin e identifikimit të zonave për investime strategjike në rajonet zhvillimore dhe studimin e fizibilitetit në këto zona, mund të jenë:

- Fondet e Reçpublikës së Kosovës dhe Komunave brenda rajonit zhvillimor;
- Grantet dhe donacionet, marrëveshje ndërkombëtare;
- Partneritete Publike-Private;
- Fonde të Veçanta për Zhvillim Rajonal.

## **11. Organizimi dhe Planifikimi i Strukturave Organizative për Zbatimin e Udhëzuesit**

Me këtë seksion synojmë të identifikojmë qëllimin dhe përmbajtjen e një pjese të udhëzuesit, duke u fokusuar në organizimin dhe planifikimin e studimit, për të arritur rezultate të suksesshme. Përmes përdorimit të fjalës organizimi dhe planifikimi theksohet rëndësia e hartimit të një plani të strukturuar dhe planifikuar të hapave konkret për të realizuar studimin me efikasitet. Shtimi i strukturave për zbatimin efikas të udhëzuesit, siguron një përshkrim të qartë të përmbajtjes së studimit dhe përcakton qëllimin e tij për të interesuarit.

**Përshkrimi i detajuar i mënyrës së organizimit të grupeve punuese:**

### **Grupi Koordinues në Nivel Qendror**

**Pjesëmarrës:** Ministria e Zhvillimit Rajonal bartëse e procesit, qendrat për zhvillim rajonal, ministrinë e linjes, ekspert nga fusha e zhvillimit rajonal, përfaqësues të sektorit privat, komuniteti dhe organizata ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë e që misioni i tyre ka të bëjë me zhvillimin rajonal.

**Roli:** Koordinator i aktiviteteve me grupet punuese në rajonet zhvillimore.

### **Detyrat:**

1. Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet për formimin e grupeve punuese në rajonet zhvillimore;

2. Koordinon aktivitetet me grupet punuese në nivel rajonal për hartimin e planit të veprimit, përcaktimin e vizionit dhe objektivave specifike, përkujdeset për progresin e projektit dhe rishikimin e buxhetit;
3. Përmes Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, dosjen të detajuar (të pranuar nga GP në nivel rajonal) që përmban të gjitha informacionet dhe dokumentacionin mbështetës për një projekt të propozuar për investim strategjik, e përcjell në Agjencionin e Investimeve dhe Eksporteve, për verifikim të kriterëve dhe të dhënave të paraqitura, i cili i rekomandon Këshillit (të kryesuar nga Kryeministri) të merr vendimin përfundimtar për shpalljen e projektit si investim strategjik (e njëjta procedurë ndiqet edhe për studimin e fizibilitetit të projekteve për investime strategjike);
4. Mbështet dhe harmonizon aktivitetet në mes të grupeve të ndryshme punuese dhe ofron alternativa për zgjidhjen e sfidave gjatë realizimit të procesit;
5. Monitoron realizimin e procesit dhe përgatit raporte të përgjithshme periodike nga raportet dhe vlerësimet e pranura nga grupet punuese rajonale;
6. Përgatit dhe menaxhon aspektet teknike dhe strategjike të komunikimit, duke përfshirë materialet që do të komunikohen me mediat, deklaratat për shtyp, prezantimet dhe dokumentet tjera shpjeguese.

### **Grupet Punuese në Nivel të Rajoneve Zhvillimore**

**Pjesëmarrës:** Ekspertë të zhvillimit rajonal, qendrat për zhvillim rajonal, përfaqësues/ekspert komunal brenda rajonit dhe përfaqësues të komunitetit lokal.

**Roli:** Kryen analizat fillestare për identifikimin e zonave të përshtatshme për investime strategjike bazuar në kriteret e përcaktuara, koordinon aktivitetet me Grupin Koordinues në Nivel Qendror.

### **Detyrat:**

1. Bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve me Grupin Koordinues në Nivel Qendror gjatë të gjitha fazave të realizimit të projektit dhe për çështje specifike;
2. Bashkëpunon me Grupin Koordinues në Nivel Qendror për hartimin e planit të veprimit, përcaktimin e vizionit dhe objektivave specifike;
3. Mbledhë të dhëna të nevojshme demografike, ekonomike, gjeografike, etj.;
4. Analizon të dhënat e mbledhura për të identifikuar zonat me potencial të lartë për zhvillim;
5. Përgatit harta dhe raporte që tregojnë zonat e propozuara për investime strategjike në rajonin zhvillimor;
6. Organizon takime/konsultime me komunitetet lokale dhe palët e interesuara për vlerësimin e ndikimeve të mundshme dhe mbledhja e rekomandimeve dhe sugjerimeve për investime strategjike;
7. Kryen analiza të detajuara të tregut dhe projekteve të mundshme për zonat e identifikuara në rajonin zhvillimor;
8. Vlerëson ndikimet mjedisore, sociale dhe ekonomike të projekteve për investime në rajonin zhvillimor;
9. Përgatit raporte që përfshijnë rekomandimet për investime strategjike në zonat e identifikuara të rajonit zhvillimor;
10. Pasi kryhen analiza dhe bënë përzgjedhjen e projekteve për investime strategjike në rajonin zhvillimor, përgatit një dosje të detajuar që përmban të gjitha informacionet dhe dokumentacionin mbështetës dhe e përcjell te Grupi Koordinues në Nivel Qendror për të vazhduar me procedurat tjera.

11. Për projekte specifike i drejtohen Grupit Koordinues në Nivel Qendror për zgjidhjen e sfidave dhe mundësive për realizimin e procesit, qoftë edhe për studim të fizibilitetit;
  12. Përgatit raporte periodike dhe aspekte teknike të komunikimit, duke përfshirë materialet që do të komunikohen me mediat, deklaratat për shtyp, prezantimet dhe dokumentet tjera shpjeguese, për rajonin zhvillimor dhe të njejta i përcjell te Grupi Koordinues në Nivel Qendror.
- 12. Interesat dhe Përfitimet nga Koordinimi i Aktiviteteve të Grupit Koordinues në Nivel Qendror dhe Grupeve Punuese në Nivel Rajonal**

Koordinimi efektiv i aktiviteteve të Grupit Koordinues me grupet punuese rajonale, është thelbësor për të siguruar suksesin e projekteve komplekse si identifikimi i zonave për investime strategjike dhe studimi i fizibilitetit për zhvillim socio – ekonomik në rajonet zhvillimore, është i rëndësishëm për arsyet si në vijim:

**Efikasiteti**, kur grupet punuese janë të koordinuara mirë, aktivitetet janë të sinkronizuara, dhe ndikojnë në përdorimin më efikas të burimeve si, në kohë, fonde, personel, teknologji dhe materiale tjera të nevojshme;

**Cilësia dhe harmonizimi i rezultateve**, siguron që të gjitha grupet të ndjekin të njejtin vizion dhe objektiva, duke prodhuar rezultate që janë në përputhje, të integruara dhe të cilësisë së lartë;

**Vendimarrje më e mirë dhe strategjike**, koordinimi i mirë i Grupit Koordinues në Nivel Qendror me grupet punuese në nivel rajonal, mundëson mbledhjen e informacionit të nevojshëm nga fusha të ndryshme të ekspertizës, duke ndihmuar në marrjen e vendimeve strategjike dhe me informacione të sakta për rajonin zhvillimor;

**Komunikim më i mirë dhe transparentë**, koordinimi i rregullt përmirëson rrjedhën e informacionit midis grupeve dhe palëve të interesuara;

**Adaptim dhe fleksibilitet**, një strukturë e koordinuar lejon që projektet të jenë më të adaptueshme ndaj ndryshimeve ose sfidave që mund të shfaqen gjatë

### **13. Përmlledhje e Udhëzuesit për Identifikimin e Zonave për Investimeve Strategjike dhe Studimin e Fizibilitetit për Zhvillim Socio – Ekonomik Rajonal**

Udhëzuesi për Identifikimin e Zonave për Investimeve Strategjike dhe Studimin e Fizibilitetit për Zhvillim Socio – Ekonomik Rajonal, ofron një planifikim të plotë dhe të gjërë për identifikimin e zonave për investimeve strategjike me ndikim në zhvillimin socio – ekonomik të rajoneve zhvillimore. Pjesa e hyrjes prezanton qëllimin dhe rëndësinë e studimit, ndërsa analizat e mundësive dhe sfidat në rajon përmbushen me njohuri të thella në aspektet teknike, ekonomike dhe mjedisore.

Metodologjia dhe metodat që do të përdoren për këtë studim, ofrojnë një pjesëmarrje të qëndrueshme dhe afatgjate, duke inkorporuar analizën e njohurive zonale, teknologjike, ndërtimore apo ekonomike që mund të disponojë një rajon dhe burimeve të disponueshme si financat, personelin, dhe burimet natyrore të cilat mund të ndikojnë në realizimin e projekteve të mundshme në rajonin zhvillimor, evaulimin e impaktit mjedisor si proces i vlerësimit dhe identifikimit të ndryshimeve potenciale që një projekt, plan apo aktivitet mund të ndikojë në mjedis, duke përfshirë ambientin fizik, biologjik dhe shoqëror si dhe hulumtimin e tregut dhe konkurrencës. Nën pikat që përmbushin çdo aspekt nga financimi deri te komunikimi prezantojnë një qasje të strukturuar dhe të plotë për të kuptuar dhe planifikuar zhvillimin e projektit në rajonin zhvillimor të caktuar.

Duke theksuar aspektet sociale, mjedisore dhe ekonomike, udhëzuesi drejton identifikimin e zonave për investime strategjike, drejt integritetit të rajoneve zhvillimore, duke përfshi edhe pjesëmarrjen e komunitetit në këtë proces. Të gjitha këto, të integruara në një vizion të qëndrueshëm, bëjnë që ky udhëzues të jetë një mjet i fuqishëm për arritje të realizimit me sukses në identifikimin e zonave për investime strategjike dhe studimin e fizibilitetit për rajonet zhvillimore me ndikim socio – ekonomik rajonal si dhe me ndikim pozitiv në zhvillimin e rajoneve.

Pas diskutimit të gjërë dhe analizës së organizimit dhe planifikimit të studimit, është e qartë se ky proces është thelbësor për arritjen e rezultateve të suksesshme. Përmes hartimit të planeve të qarta, strukturave të përshtatshme dhe hapave efikasë për të përmbushur qëllimet e përcaktuara, mund të sigurohet një realizim efikas dhe i përshtatshëm i studimit.

Koordinimi i veprimeve dhe bashkëpunimi mes grupeve punuese të nivelit qendror dhe rajonal, përmirëson efikasitetin dhe cilësinë e të dhënave të grumbulluara. Në përgjithësi, organizimi dhe planifikimi i duhur ndikon drejtëpërdrejtë në rezultatin dhe ndikimin e studimit, duke siguruar që rezultatet të jenë të qëndrueshme dhe të përcaktueshme për të ardhmen e rajoneve zhvillimore, ku si pasojë do të kemi rajone me zhvillim të qëndrueshëm socio – ekonomik dhe të balancuar.